

Terma Reference

Për Koordinatorët Lokalë të Projektit "Të rinjtë PRO punësimit të denjë"

Projekti: Të rinjtë PRO punësimit të denjë

Institucioni Zbatues: Instituti për Zhvillim dhe Iniciativa Qytetare (IZHIQ)

Mbështetja Financiare: Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF)

Kohëzgjatja e Projektit: Shtator 2024 – Shtator 2025

Zona e Mbuluar: Bashkitë e Lezhës, Shkodrës dhe Tiranës

Qëllimi i Projektit: Ulja e nivelit të papunësisë dhe rritja e punësimit të denjë tek të rinjtë në zonat e përzgjedhura, duke nxitur zhvillimin e ideve inovative për krijimin e biznesit dhe përfshirjen në jetën ekonomike dhe sociale të komunitetit. **IZHIQ është në kërkim të tre koordinatorëve lokalë** për secilën nga zonat e mëposhtme: Lezhë, Shkodër dhe Tiranë. Roli i koordinatorit lokal është kyç për arritjen e objektivave të projektit dhe për ndërlidhjen e komunitetit të rinjë në mënyrë aktive.

1. BACKGROUND

1.1 Autoriteti Kontraktues

Shoqata "Instituti për Zhvillim dhe Iniciativa Qytetare"- IZHIQ është krijuar me vendim gjykatë më 19.07.2019 si një shoqatë me anëtarësi. IZHIQ është organizatë jofitimprurëse, joqeveritare dhe jopolitike. Misioni i IZHIQ është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me fokus të veçantë tek respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të grave, të rinjëve, grupeve vulnerabel si dhe fuqizimi ekonomik i grupeve vulnerabel dhe të komuniteteve të tjera shoqërore, të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, konventat ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacioni në fuqi.

1.2 Rreth projektit

Projekti "Të rinjtë PRO punësimit të denjë":

IZHIQ përmes këtij projekti synon të promovojë punën e denjë nëpërmjet sipërmarrjes dhe inovacionit, si mundësi e mirë për punësimin dhe vetëpunësimin mes të rinjëve në Bashkinë Shkodër, Lezhë dhe Tiranë dhe përfshirjen e tyre në jetën social-ekonomike të rajonit ku jetojnë.

Kjo do të realizohet nëpërmjet një sërë aktivitetesh që synojnë informimin dhe rritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe komunitetit në Shkodër, Lezhë dhe Tiranë për krijimin, rritjen dhe qendrueshmërinë e sipërmarrjeve lokale nëpërmjet aplikimit të metodave inovative. Qëllimi kryesor i projektit është të identifikohen grupe të rinjsh që rrezikohen nga marginalizimi në tregun e punës, të kuptohen qasjet e tyre ndaj kërkimit të punës, të identifikohen kërkesat e tregut të punës për të rinjtë etj. Projektit synon të rrisi ndërgjegjësimin dhe kapacitetet e të rinjve për t'u punësuar në bizneset lokale ose për të krijuar nisma të vetëpunësimit, duke amplifikuar dhe përmirësuar dhe më tej aftësitë e tyre.

2. PËRSHKRIMI I POZICIONIT

2.1 Përgjegjësitë Specifike dhe Rezultatet e Pritura

Koordinatorët lokalë do të kenë përgjegjësi të qarta për të siguruar arritjen e rezultateve kryesore të projektit në zonat e përzgjedhura:

1. **Organizimi i Aktiviteteve Lokale:** Organizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve për rritjen e punësimit të të rinjve në Bashkitë e Lezhës, Shkodrës dhe Tiranës.
2. **Komunikimi dhe Ndërlidhja:** Shërbimi si pika kryesore e kontaktit midis IZH&IQ dhe të rinjve të zonës për të lehtësuar procesin e përzgjedhjes dhe mbështetjes së pjesëmarrësve.
3. **Mbështetje dhe Mentorim:** Identifikimi i nevojave të të rinjve për zhvillim profesional dhe orientimi i tyre drejt trajnimeve dhe mundësive të punës.
4. **Monitorimi dhe Raportimi:** Koordinatorët do të paraqesë raporte të rregullta për përparimin e aktiviteteve dhe impaktin në të rinjtë e përfshirë.

2.2 Rezultatet e Pritura:

- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete të trajnimit dhe mentorimit për punësim.
- Lehtësimi i integritetit të të rinjve në tregun e punës dhe inkurajimi i sipërmarrjes së tyre.
- Rritja e ndërgjegjësimin dhe përfshirjes së komunitetit në mbështetjen e projekteve të punësimit të të rinjve.

2.2 Menaxhimi i Detyrës

2.2.1 Organi Përgjegjës

- Koordinatorët do të raportojnë tek menaxheri i projektit në IZH&IQ dhe do të bashkëpunojnë ngushtë me stafin e IZH&IQ për implementimin e aktiviteteve lokale.

2.2.2 Koha e Detyrës

Ky pozicion është i përkohshëm dhe pritet të zgjasë deri në përfundimin e projektit në Shtator 2025. Orari është fleksibël, por koordinatorët duhet të jenë të pranishëm për të gjitha aktivitetet e planifikuara dhe të respektojnë afatet për raportimin e detyrave. Shërbimi i ofruar përfshin 17 ditë pune për secilin kordinator.

3. KUALIFIKIME DHE KRITERE PËR PËRZGJEDHJEN

- **Banor i Zonës përkatëse:** Kandidatët duhet të jenë banorë të Bashkisë së Lezhës, Shkodrës ose Tiranës.
- **Eksperiencë në Koordinim Projektesh:** Minimumi 2 vite përvojë në menaxhimin dhe koordinimin e projekteve të ngjashme, në veçanti ato që përfshijnë të rinjtë.
- **Aftësi të Mira Komunikative dhe Ndërpersonale:** Aftësi për të bashkëpunuar me të rinjtë dhe grupet e komunitetit për të krijuar dhe përmirësuar mundësitë e punësimit.
- **Aftësi Organizative dhe Menaxhuese:** Aftësi për organizim efikas të aktiviteteve dhe mbajtjen e shënimeve për raportim.
- **Njohuri mbi Sektorin e Punësimit të të Rinjve:** Njohuri të thelluara mbi sfidat e tregut të punës për të rinjtë dhe mbështetja e tyre në zhvillimin e aftësive për punësim.

3.1 Afati dhe Procedura e Aplikimit

Afati i fundit për të konfirmuar ftesën për bashkëpunim: 5 Nëntor 2024

Aplikuesit e interesuar duhet të dërgojnë CV-në e tyre, në format PDF, leter interesi dhe ofertën financiare në adresën info@izhiq.org.al

Ofertë Financiare

Titulli I Projektit:	Të rinjtë PRO punësimit të denjë
Subjekti:	Koordinator Lokal për zonat: Lezhë, Shkodër, Tiranë.
Autoriteti Kontraktues:	Instituti për Zhvillim dhe Inisiativa Qytetare

INFORMACIONI I OFERTUESIT

Dërguar nga:

Emër dhe Mbiemer	
Adresa	
Telefon	
e-mail	

DEKLARATA E OFRUESIT

Unë, i/e nënshkruari/a, deklaroj se ofroj të siguroj shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës, bazuar në dokumentet e mëposhtme:

- CV
- Leter Interesi
- Oferte Financiare

OFERTA FINANCIARE

Numri i ditëve të parashikuara për këtë shërbim është 17 ditë

Tarifa ditore për këtë shërbim është _____ ALL/dita

Shuma Totale: _____ ALL

Emër	
Data	